

V E N D I M

Nr.340, datë 23.5.1998

PËR KOMPETENCAT E BORDIT KOMBËTAR TË USHQIMEVE

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Bordi Kombëtar i kontrollit të ushqimeve është organ këshillimi, konsultimi dhe koordinimi i të gjithë veprimtarisë së kontrollit ushqimor në Republikën e Shqipërisë.
2. Detyrat kryesore të Bordit Kombëtar të kontrollit të ushqimeve janë:
 - Përcakton përparësitë e kontrollit ushqimor në Republikën e Shqipërisë.
 - Bashkërendon veprimtarinë e përbashkët të organeve të kontrollit të ushqimit të parashikuara me ligj, si dhe ndërmjet strukturave të pushtetit qendror e lokal.
 - Bashkërendon punën ndërmjet qendrave të referencës së kontrollit ushqimor, si dhe laboratorëve të ngarkuar me analizat e produkteve ushqimore, për shmangien e paralelizmave dhe mosmarrëveshjeve mes tyre.
 - Sugjeron hartimin ose rishikimin e akteve nënligjore, urdhëresave, rregulloreve etj. dhe i shqyrton ato para paraqitjes për miratim në organet përkatëse.
 - Bashkëpunon me organe të tjera, si ato shkencore, informative, edukative dhe arsimore, për të zhvilluar një interes e kuptim të plotë për cilësinë dhe sigurinë e ushqimeve, si dhe për një kualifikim të vazhdueshëm në këtë fushë.
 - Inkurajon marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me organizmat ndërkombëtare në fushën e kontrollit ushqimor.
 - Ndhmon në zgjidhjen e problemeve që ngrihen nga konsumatorët, prodhuesit dhe tregtarët nëpërmjet udhëzimeve e rekomandimeve në zbatim të ligjeve e vendimeve në fuqi.
3. Pranë Bordit Kombëtar të kontrollit të ushqimeve ngrihet sekretariati, i cili ngarkohet për bashkërendimin e punës ndërmjet pjesëmarrësve, organizimin e takimeve, përgatitjen e rendit të ditës, përgatitjen e dokumenteve dhe materialeve për shqyrtim, mbajtjen e korrespondencës brenda dhe jashtë vendit, mbajtjen e arkivit dhe kryerjen e të gjithave veprimtarive të nevojshme për funksionimin normal të Bordit Kombëtar të kontrollit të ushqimeve.
4. Sekretariati përbëhet nga dy sekretarë (një specialist në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe një specialist në Ministrinë e Shëndetësisë me seli të përkohshme në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit).
5. Bordi kombëtar i kontrollit të ushqimeve të mbledhet, si rregull, një herë në tre muaj. Takimet, problemet e trajtuara dhe detyrat e marra mbahen në arkivin e bordit. Kryetari i Bordit informon rregullisht Kryetarin e Këshillit të Ministrave për zbatimin e kompetencave të ngarkuara me ligj.
6. Vendimet e Bordit merren me votim. Bordi mund të mbledhet kur numri i pjesëmarrësve të tij është jo më pak se 9 anëtarë. Vendimet e Bordit merren me shumicë absolute të të pranishmëve. Bordi mund të marrë vendime edhe në mungesë të kryetarit, i cili mund të autorizojë një anëtar bordi për ta zëvendësuar.
7. Kur një projekt miratohet nga Bordi, ai u parashtrohet për shqyrtim e miratim organeve përkatëse.
8. Çdo anëtar i Bordit, për pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
KRYEMINISTRI

Fatos Nano